


SPECIFIKIME TEKNIKE

(Shtojce , ne sherbim te objektit :” Ujshellesi Prokpi – Pafal , komuna Sinje ”)

Ne keto specifikime teknike jepen zhvillimet e punimeve dhe kerkesat teknike per zbatimin e projektit , ne kete objekt.

1. Kontraktori i punimeve eshte i detyruar te zbatoje keto specifikime teknike .
2. Projekti permban te gjitha te dhenat e domosdoshme , qe i sherbejne zbatimit te punimeve.
3. Per cdo mosperputhje , pas realizimit te azhornimeve perkatese , duke shfrytezuar bashkepunimin e mbikqyresit te punimeve dhe autoret e projektit , te behen ndryshimet perkatese , duke hartuar dokumentacionin e duhur , te miratuar nga punedhenesi.
4. Specifikimet teknike perfshijne te gjitha punimet e parashikuara per tu kryer.
5. Perpara fillimit te punimeve , te behet azhornimi ne terren .Ndryshimet e mundshme , pasi i referohen mbikqyresit te punimeve , i pasqyrohen projektuesit dhe investitorit per miratim.
6. Punimet e germimit do te realizohen sipas prerjeve terthore .
7. Punimet e germimit do te kryhen me makineri , te pershtatshme per keto lloj punimesh , si dhe me krahe per te realizuar konfiguracionet perkatese.
8. Germimet do te realizohen deri ne kuoten e duhur te bazamenteve te pershtatshme .Vleresimi do te behet nga mbikqyresi i punimeve , qe do te beje (nese eshte e nevojshme) ndryshimet perkatese.
9. Gjate procesit te germimeve , te respektohen kushtet teknike te zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik ne pune.
10. Punimet per ndertimin e depove (grumbulluese dhe shperndarese) do te realizohen sipas projektit pasi te gjendet bazamenti i pershtatshem .Lidhjet e hekurit dhe sasia e tij te kontrollohen para betonimit nga mbikqyresi i punimeve.
11. Punimet e betonit te realizohen sipas projektit dhe KTZ.Te behet trajtimi i betonit gjate stazhionimit te tij.
12. Punimet per vepren e marrjes do te realizohen megermimme makineri dhe me krahe .Pasi te kapet burimi ne formacionin baze (shkemb) te realizohet vepra e marrjes sipas projektit.
13. Punimet per realizimin e stacionit te pompave te realizohen sipas projektit .
14. Gjate punimeve te ruhen kuotat perkatese te burimit , depos grumbulluese dhe stacionit te pompave per nje rregjim normal pune .
15. Kanali per vendosjen e linjes sedergimit ne depo te realizohet sipas profilit te dhene ne projekt.
16. Te respektohen KTZ, per cdo lloj punimi .
17. Linja elektrike TM te realizohet sipas te dhenave ne projektin elektrik.
18. Perpara venies ne pune te objektit te behen provat me ngarkese e tij per te eliminuar defektet e mundshme (linja e dergimit , hyrje – daljet e pompave , panelet e komandimit etj.).
19. Provat e betoneve dhe te gjithe materialeve te ndertimit , qe perfshihen ne specifikimet teknike te ketij objekti , jane te detyrueshme te behen ne laboratore te certifikuar , e te respektohen nga kontraktori dhe mbikqyresi i punimeve .
20. Cimentua , qe do te perdoret per betonet , do te jete Portland antisulfate ne perputhje me standartin shqiptar STASH 501-87 dhe 503-87.

Ing. Lefter Ndrilo



LEFTER NDRILO
Bik&Kola, M, K0230
Ndertim&Projektim
Z2723/2, K0543/2